

# MIKA-D

Instrument matës për Analizën e  
Kompetencave – Gjermanisht

Informacion për prindërit  
dhe kujdestarët ligjorë

**MIKA-D**

Shqip  
(Albanisch)

## **Printimi**

IQS – Institut des Bundes für Qualitätssicherung im österreichischen Schulwesen  
(Instituti Federal për Sigurimin e Cilësisë në Sistemin Shkollor Austriak)  
Alpenstraße 121, 5020 Salzburg

Fotografia: stock.adobe.com: Seventyfour (Cover, fq. 5/6), Monkey Business (fq. 3),  
Rido (fq. 7)

Salzburg, 2022

Fëmija juaj duhet të marrë pjesë në një test MIKA-D dhe ju doni të dini se çfarë është saktësisht? Në këtë fletë informacioni do të gjeni të gjitha informacionet e rëndësishme për MIKA-D, orë mësimore për përmirësim të gjermanishtes dhe kurse përmirësuese të gjuhës gjermane.

## Çfarë është MIKA-D?

MIKA-D do të thotë *instrument matës për analizën e kompetencave – gjermanisht (Messinstrument zur Kompetenzanalyse – Deutsch)*. Me MIKA-D, mësuesit kontrollojnë se sa mirë flet fëmija juaj gjermanisht dhe nëse ai/ajo mund t'i ndjekë mësimet në gjermanisht. Ekziston një version për **nivelin fillor** (“niveli fillor MIKA-D”) dhe një version për **nivelin e mesëm** (“niveli i mesëm MIKA-D”).

Me MIKA-D, në një bisedë kërkohen fusha të ndryshme gjuhësore, për shembull fjalori dhe të kuptuarit e gjuhës (më shumë për këtë në faqen 5).

Testi zgjat maksimumi **30 minuta**.

MIKA-D **nuk është një provim** si për shembull një detyrë shkollore. Nxënëset/Nxënësit **nuk marrin notë**.

## Përse fëmija im duhet të bëjë testin?

Rezultati i MIKA-D përcakton se cilin **kurs të gjuhës gjermane** do të marr fëmija juaj (më shumë për këtë në faqet 2–3). Fëmija juaj ose do të caktohet në një klasë për përmirësim të gjermanishtes, në një kurs për përmirësim të gjermanishtes ose në një klasë të rregullt. **Çdo semestër**, MIKA-D teston nëse fëmija juaj ka ende nevojë për kursin e gjuhës gjermane ose jo (më shumë për këtë në faqen 4).

## Ekzistojnë tre rezultate të ndryshme në MIKA-D:

### 1. Klasa për përmirësim të gjermanishtes

Fëmija juaj hyn në klasën për përmirësim të gjermanishtes dhe bëhet nxënës i veçantë ("**status i veçantë**"). Në shkollën **fillore**, fëmija juaj mëson gjermanisht në klasën plotësuese të gjermanishtes për **15 orë në javë**, në mënyrë që së shpejti t'i kuptojë më mirë mësimet në klasën e rregullt. Në shkollën e **mesme** është 20 orë në javë.

Në orët e mbetura fëmija merr pjesë në orët e rregullta mësimore, për shembull në "Stërvitje dhe sport" ose në udhëtimet me klasën. Çdo shkollë e rregullon këtë në mënyra të ndryshme.

### 2. Klasë e rregullt me kurs për përmirësim të gjermanishtes

Me këtë rezultat fëmija juaj vjen (për të paktën një semestër) **6 orë në javë** në kursin për përmirësim të gjermanishtes. Kështu është edhe në shkollën **fillore** dhe të **mesme**. Në orët që mbeten fëmija juaj është në klasë mësimore të rregullt. Edhe me këtë rezultat MIKA-D fëmija juaj merr "**statusin e veçantë**".

### "Statusi i veçantë"

Nëse fëmija juaj vendoset në një klasë për përmirësim të gjermanishtes ose në një kurs për përmirësim të gjermanishtes, ai merr "status të veçantë". Këtu fëmija juaj mund të përqendrohet plotësisht në mësimin e gjermanishtes.

"Statusi i veçantë" është i vlefshëm për **maksimumi 2 vite** (4 semestra). Prandaj fëmija juaj nuk është në një klasë për përmirësim të gjermanishtes ose në një kurs për përmirësim të gjermanishtes për më shumë se 2 vite. Fëmija juaj më pas do të marrë automatikisht "statusin e rregullt" – pavarësisht se cilin rezultat MIKA-D merr fëmija juaj.

### 3. Klasa e rregullt

Nëse fëmija juaj është në gjendje të ndjekë mësimet, ai/ajo hyn në klasën e rregullt si nxënëse/nxënësi i rregullt ("**status i rregullt**").

Fëmija juaj nuk duhet të flasë gjermanisht të përsosur për këtë. Edhe me "statusin e rregullt", fëmija juaj mund të marrë **ndihmë për të mësuar gjermanisht**.

### "Statusi i rregullt"

Ju merrni "statusin e rregullt", ...

- nëse rezultati në MIKA-D është "mjaftueshëm" ose
- nëse fëmija juaj ka qenë në një klasë për përmirësim të gjermanishtes ose në një kurs për përmirësim të gjermanishtes për një total prej 2 vitesh.

**Nëse dëshironi të dini më shumë për mbështetjen e gjuhës gjermane, gjëja më e mirë që mund të bëni është të pyesni shkollën tuaj!**



## Kur aplikohet MIKA-D për testim?

Mësueset dhe mësuesit testojnë me MIKA-D ...

1. në **regjistrimin në shkollë\***
2. ose nëse fëmija juaj është tashmë në një klasë për përmirësim të gjermanishtes ose në një kurs për përmirësim të gjermanishtes **një herë në semestër**. Kjo do të thotë: Do të kontrollohet vazhdimisht nëse fëmija juaj ka ende nevojë për kursin e gjuhës gjermane apo jo
3. ose nëse sapo keni ardhur në Austri, fëmija juaj sapo po mëson gjuhën gjermane dhe është **i ri në një shkollë austriake**.

### **\*Informacion për të regjistruarit në shkollë**

Nëse fëmija juaj është rreth 6 vjeç, shkoni bashkë me fëmijën tuaj përregjistrimin në shkollën e re. Këtu në një bisedëvëzhgohet nëse fëmija juaj është gati për shkollë. Më pas, drejtorja e shkollës vendos nëse MIKA-D duhet të kryhet edhe me fëmijën tuaj. Nëse po, do të bëhet një takim i dytë për këtë.



## Çfarë testohet në MIKA-D?

Në **nivelin fillor** të MIKA D testohen fusha të ndryshme:

- **Fusha e "Fjalorit"** (fjalorit): Fëmijës suaj i shfaqet një fotografi e madhe. Më pas duhet të thotë se çfarë sheh në fotografi.
- **Fusha "Përgjigjuni pyetjeve"**: Fëmija juaj duhet t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me këtë figurë këtu.
- **Fusha "Tregoni histori me figura"**: Fëmijës suaj i shfaqen disa histori me figura me nga tre figura secila. Fëmija juaj më pas duhet të tregojë historinë.
- **Fusha "Të kuptosh fjalitë"**: Fëmijës tuaj i thuhet një fjali. Më pas duhet të zgjedhë figurën që i përshtatet fjalisë nga katër fotografi.

Në **shkollën e mesme** MIKA D ka një fushë tjetër:

- **Plotësoni "tekstet me boshllëqe"**: Fëmija juaj duhet të plotësojë boshllëqet në dy pjesë të tekstit ku mungojnë disa fjalë.



## A duhet fëmija im të mësojë për MIKA-D?

Fëmija juaj **nuk duhet të mësojë drejtpërdrejt** për MIKA-D. Është më mirë nëse fëmija juaj praktikon gjuhën gjermane **në përgjithësi**. Për shembull:

1. Flisni me persona të tjerë që e kanë **gjermanishten si gjuhë të parë**.
2. **Lexoni libra**. Nxiteni fëmijën tuaj të lexojë libra në gjermanisht. Nëse dëshironi, mund t'i lexoni Ju fëmijës tuaj ose të lexoni së bashku (sidomos në shkollën fillore). Bëni pyetje fëmijës dhe flisni për atë që ndodh në libër. Ka edhe shumë libra në gjermanisht **me përkthime në gjuhë të tjera**. Nëse ju vetë nuk flisni mirë gjermanisht, lexojini fëmijës tuaj në gjuhën tuaj të parë. Kjo ndihmon në mësimin e të gjitha gjuhëve të tjera.
3. Përdorni oferta të tilla si **ditët e leximit** në biblioteka (gjithashtu online). Mësoni më shumë në faqet e internetit të bibliotekave në vendbanimin tuaj.
4. **Dëgjoni libra audio** në gjermanisht.
5. **Përdorni media** në gjermanisht (p.sh. televizion, filma, seriale, video lojëra).
6. **Përdorni mediat sociale** në gjermanisht (p.sh. podcast, YouTube, rrjete sociale, blogje).





**Më shumë informacion mbi MIKA-D:**

[https://www.bmbwf.gv.at/Themen/schule/schulpraxis/ba/sprabi/mika\\_d.html](https://www.bmbwf.gv.at/Themen/schule/schulpraxis/ba/sprabi/mika_d.html)

**Më shumë informacion mbi klasat për përmirësim të gjermanishtes dhe kurset për përmirësim të gjermanishtes:**

<https://www.bmbwf.gv.at/Themen/schule/schulpraxis/ba/sprabi/dfk.html>

**Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi na telefononi në: 43 662 620088-3600 ose shkruani një email në: [MIKA@iqs.gv.at](mailto:MIKA@iqs.gv.at).**